



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 103/13
Prishtinë, më 26.04.2013, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Sevdije Lama, Xhevdet Neziraj, Duda Balje dhe Albana Fetoshi.

Munguan: Naser Osmani

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Enver Halimi dhe Ejup Hasolli –ZRRE, Ibush Jonuzi , Haradin Gërvalla dhe Midin Bojaxhiu –KPMM, Ramadan Avdiu dhe Hajdar Korbi –MF, Raif Preteni dhe Ramiz Krasniqi –ZRRUK ,Ili Ahmeti ,Shkëlzen Qorri –ARRH, GAP , Zyra pranë Presidentes ,Kosova Press, Kosova Sot.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 12.04.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116;
5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2012;
6. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012;
7. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012;
8. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012;
9. Shqyrtimi i Projektligjit për transportin rrugor me amendamentet e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
10. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-191 për Blegtorinë me amendamentet e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja Propozoj ndryshimin e pikave të rendit të ditës, përkatësisht pikat 3 dhe 4 të zhvendosen pas pikës 5 dhe 6.

Konstatohet se miratohet rendi i ditës me këtë ndryshim .

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 12.04.2013

Kryetarja konstatohet se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës Rregullative për Energji për vitin 2012

Kryetarja në bazë të Ligjit të ZRRE i dërgon Kuvendit raportin e punës, ku në kuadër të raportit të punës duhet të përfshihet edhe raporti financiar. ZRRE i ka përgaditur dhe dorëzuar raportin sipas formularëve standard. Nga përmbajtja e raportit shohim se janë shpenzuar mjetet diku 94.85% dhe siç e dimë kjo zyrë realizon të hyra të cilat janë diku 689,834.92€.

Enver Halimi prezantoi raportin financiar të ZRRE-së ku krahasuar me buxhetin e vitit 2011, këtë vit buxheti i ZRRE-së ka një rritje prej 3,000 € në kategorinë e shpenzimeve kapitale, ndërsa të kategoritë tjera është i njëjtë me vitin paraprak. Realizimi i buxhetit në raport me buxhetin e aprovuar për vitin fiskal 2012 është 94.85%. Prezantoi shkallën e realizimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike. Gjatë vitit 2012, ZRRE-ja ka realizuar të hyra në shumë prej 589,555.92€. Ndërsa nga të hyrat e pashpenzuara për vitin 2011, ZRRE ka bartur shumën prej 109,279.00€. Shuma totale e të hyrave të mbledhura dhe të bartura të ZRRE-së është 689,834.92€, gjegjësisht 20,378.92€ më shumë se sa buxheti i ZRRE-së për vitin 2012. Me qëllim të harmonizimit të hyrave me buxhetin ZRRE-së për vitin 2012, Bordi i ZRRE-së në seancën e mbajtur më 01.10.2012, ka marrë vendim që për periudhën kohore mars-tetor 2012, të licencuarit të lirohen nga obligimi i pagesës së taksës vjetore. Kështu të licencuarit janë liruar nga pagesa e taksave në një shumë të përgjithshme prej 771,824.52€.

Kryetarja theksoj se Komisioni për Buxhet dhe Financa çdo herë i ka miratuar kërkesat e ZRRE, mirëpo në nuk kemi miratuar listën e pagave të cilën e ka miratuar bordi i drejtorëve të ZRRE-së, që të rriten pagat dhe mëditjet e këtij institucioni dhe në takimin që kemi pasur nuk kanë mundur të na japin arsyeshmëri për rritjen e mjeteve për paga dhe mëditje. Gjatë raportimit tuaj, thotë që ZRRE financohet nga të hyrat vetanake dhe të hyrat e pamjaftueshme financohen nga granti qeveritar, atëherë çfarë logjike ka miratimi i vendimit të bordit të ZRRE-së për zvogëlimin e taksave dhe nuk di a shkruan kështu ligji juaj. Buxheti i Kosovës financohet nga mjetet që realizohen brenda Kosovës, pra me të hyrat të cilat i realizojnë institucionet. Pra atëherë nëse ju jeni në krizë si don që tu financoj grandit Qeveritar kur ju merrni vendim t'i zvogëloni të hyrat e juaja ngase nuk keni nevojë për të hyra tjera.

Sali Asllanaj në këtë raport të ZRRE-së shohim se ka një disproportion të madh me kategoritë e tjera ku 672,000 euro janë të shpenzuara për paga apo 60 % e buxhetit. Po ashtu më duket absurde si merrni vendime për lirim nga taksat operatorët e licencuar, mendoj se mund të jetë defekti i madh ligjor që ju të bëni atë lirim. Ky lirim nga taksat nuk besoj që do të ketë ndikim tek konsumatorët, ju mund të na thoni se do të reflektohet në çmimin e energjisë tek konsumatorët mirëpo efektet e këtyre masave do të reflektohen vetëm tek institucioni juaj.

Latif Gashi është absurde që afaristët apo të interesuarit për licenca të lirohen nga pagesa e taksës. Ju jeni të obliguar që mjetet t'i derdhni në buxhet, andaj nuk e kuptoj këtë vendim të juaj që ti lironi të licencuarit nga pagesa e taksës. Po ashtu tek kategoria mallra dhe shërbime, keni planifikuar shumë më

pak e keni shpenzuar 100% më shumë, ku është fjala për shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënie kanë qenë të planifikuara 6,000 euro ndërsa janë shpenzuar 12,885 euro. Tek udhëtimet kemi tejkalime prej 122% më shumë. Gjithashtu keni insistuar çdo herë që të ngritni numrin e të punësuarve, ndërsa nuk i keni plotësuar atë, 5 pozita janë të paplotësuara. Meqë nuk i keni rekrutuar të gjithë punëtorët, si është e mundur të shpenzoni buxhetin në shumë aq të lartë, a mos është shpërndarë buxheti për punëtorët ezksitues.

Albana Fetoshi tek shpenzimet e udhëtimit nga 37,400 të planifikuara janë shpenzuar 45,731€ apo 22% më shumë se që janë planifikuara, me çka e keni mbuluar këtë shumë shtesë që e keni shpenzuar?

Hasime Krasniqi në bazë të këtij raporti që na është ofruar, është për t'u habitur që përfaqësuesit e ZRRE-së thonë që pas plotësimit të nevojave tona si kuadër apo si të punësuar dhe nuk kemi më nevojë të bëjmë inkasimin e mjeteve të tjera. A është interesi i Kosovës dhe i qytetarëve të Kosovës që ZRRE-ja të funksionoj si duhet apo vetëm plotësimi i kërkesave dhe nevojave të të punësuarve në ZRRE.

Ejup Hasolli fillimisht sa i përket lirimit nga taksat, të hyrat e ZRRE-së janë të hyra të dedikuara dhe janë të liruara nga taksat, andaj nuk duhet të krahasohen me të hyrat doganore dhe tatimore.

Latif Gashi nëse keni krizë me çka financoheni.

Ejup Hasolli nuk ka ndodhur asnjëherë që ZRRE-ja të jetë në krizë. Vazhdimisht për këtë çështje ne kemi dhënë shpjegime, çdo vitë dhe me duket se i kemi dhënë sqarimet e nevojshme. Nëse të hyrat e ZRRE-së janë të hyra të dedikuara për ZRRE dhe nuk kemi obligim ligjor të mbledhim të hyra për buxhetin e Kosovës.

Kryetarja në cilin nen të ligjit jeni bazuar që e keni marrë këtë vendim.

Latif Gashi propozoi që ky raport të mos miratohet deri kur të na sjellin listën saktësisht me paga dhe sqarime shtesë pse janë liruara të licencuarit dhe të na japim arsyetime të bazuara në ligj mbi bazën e cilit ligj i keni rritur pagat aq shumë.

Hykmete Bajrami pajtohem me të gjitha komentet e kolegëve deputet, dhe i bashkangjitet propozimit të z. Gashit, mirëpo edhe un kam një propozim shtesë. Ne si komision për Buxhet dhe Financa po shohim anomalitë që ka ligji për ZRRE-në, mendoj që pos asaj që nuk po e miratojmë këtë raport, hap i dytë është që të hyrat shtesë që i kanë ti derdhin në buxhetin e Kosovës, ngase në rast të krize këta financohen nga granti qeveritar pra mos të mbesin vetëm në nivelin e të hyrave të dedikuara.

Enver Halimi për sa i përket rritjes së pagave, ZRRE-ja që nga viti 2010 nuk ka pasur rritje të pagave

Hykmete Bajrami atëherë si shpjegohet që buxheti i shpenzuar për pesë punëtorët që nuk i keni punësuar?

Enver Halimi shpjegohet në atë mënyrë që kërkesa e ZRRE-së është e planifikuara nuk është aprovuar asnjëherë. Në vitin 2008 buxheti i ZRRE-së për paga ka qenë 401,00 euro, tani është 370,000 euro pa asnjë paralajmërim apo njoftim na është zvogëluar buxheti nga Ministria e Financave, si pasojë e zvogëlimit të këtij buxheti nuk ka qenë e mundur të plotësohen, por jo që janë rrit pagat. Në takimin e ardhshëm mund ta sjellim një raport shtesë.

Kryetarja buxheti ka qenë i miratuar për të gjithë të punësuarit, jo sipas listës së pagave të cilën e ka miratuar bordi po sipas listës së pagave të cilat kanë qenë në sistem. Janë miratuar pagat për 33 të

punësuar por nuk janë miratuar një pjesë e shtesave prej 27,000 euro të cilat kanë qenë të parapara për mëditje dhe shtesa të tjera dhe ju lutëm sjellin edhe listën e pagave, si i keni ekzekutuar pagesat prej 1 Janarit - 31 Dhjetor. Po ashtu na sjellin vendimin për uljen e tarifave të taksave mbi çka jeni bazuar çfarë arsyeshmërie ka të ulen tarifat dhe si ka reflektuar kjo në uljen e çmimeve dhe një arsyeshmëri për tejkalimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe për shpenzimet këshilluese dhe intelektuale.

Pas diktimit dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxorri këtë

Përfundim

Shtyhet Raporti financiar i ZRRE-së për vitin 2012 për shqyrtim në një takim tjetër të komisionit. Kërkojmë nga ZRRE-ja të sjell listën e pagave prej 1 Janarit deri me 31 Dhjetor 2012. Vendimin për uljen e tarifave dhe taksave, çfarë arsyeshmërie ka të ulët kjo tarifë. Çka ka përfituar qytetari prej kësaj dhe kush ka përfituar nga kjo ulje. Arsyeshmëria për tejkalimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimet këshilluese dhe intelektuale. Raporti financiar i ZRRE-së do shqyrtohet në një takim tjetër të komisionit pas marrjes së informatave shtesë.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012

Kryetarja KPMM është e obliguar që të dorëzojë raportin vjetor financiar i cili i bashkangjitet raportit të punës. Nga raporti shohim se buxheti është shpenzuar prej 83.8%, të hyrat prej 6,413,535 ku janë të detalizuar edhe burimet e të hyrave. Paga dhe Mëditjet janë shpenzuar 98.4%, Mallra dhe Shpenzimet 82.4%, Shpenzimet Kapitale 60.7% dhe të jepni shpjegime pse ka ngecje këtu në drejtim të realizimit të mjeteve .

Ibush Jonuzi KPMM gjatë vitit 2012 ka pasur buxhetin e aprovuar në vlerë prej 1,697,564 euro dhe pas rishikimit të buxhetit të KPMM-së buxheti përfundimtar, për vitin 2012 është 1,505,564 euro ky kursim ka shkuar në investime kapitale 170,000 dhe 20,000 në subvencione dhe transfere. Gjatë vitit 2012 KPMM-ja ka pasur disa vështërsi, dhe atë në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje dhe Investime Kapitale. Për Paga dhe Mëditje gjatë vitit 2012 nuk ka pas mundësi ta rekruton stafin prej 79 pozitave që i ka aprovuar, prandaj i njëjti problem është duke na u shfaqur nga viti 2011-2012 dhe tash në vitin 2013. Ne kemi kërkuar buxhet shtesë për këto pozita por nuk kemi gjet mbështetje financiare për kategori ekonomike. Për Investimet Kapitale KPMM-ja gjatë vitit 2012 nuk ka mundur të zhvillojë Projektin Avancimi i Geodatabazës. Ky projekt nuk ka mundur të realizohet në vitin 2012 për arsye se kompania e cila është edhe krijuese e kësaj Baze të të Dhënave nuk e ka dorëzuar kodin burimor. Për kategoritë e tjera ekonomike KPMM-ja gjatë vitit 2012 nuk ka pas vështirësi financiare.

Latif Gashi për sa i përket pozitave ju keni të aprovuara 79 pozita e prej tyre vetëm 72 pozita janë të rekrutuara, ndryshimi është për 7 punëtor, me arsyetime se nuk keni gjetur mbështetje financiare. Si arsyetohet kjo kur ju keni pas mbështetje në bazë të ligjit të buxhetit. Çka ka ndodhur me ato mjete i ka tërhequr mbrapa Qeveria apo i keni shpërndarë në punëtorët tjerë. Po ashtu tek Projektet Kapitale e keni buxhetin e shpenzuar vetëm 67% dhe këto mjete i keni kthyer në Ministrinë e Financave, cila është arsyeja që nuk i keni realizuar këto projekte kapitale.

Sevdije Lama më 27 prill të viti 2012 në Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e kemi bërë një vizitë në tregëlltoren “Nikies” në Gjakovë. Gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit për vlerësimet e ndikimit në mjedis, ku kanë qenë prezent edhe inspektorati juaj, kemi parë që ata operojnë pa asnjë leje apo licence. A keni marrë ndonjë hapë që t’ju boni presion që ata të aplikojnë ose a keni bërë ndonjë gjë në këtë drejtim.

Ibush Jonuzi ne i kemi të gjitha gjrobat, kallëzimet penale në Gjykata të cilat janë në vlerën 6,527.022 euro që presim të realizohen, dhe që e tejkalon shumë e planifikimit .Ndërsa çështja e 79 të punësuarve , ne kemi mungesë të stafit profesional është premtuar se do të t'ju ndihmojmë në atë drejtim dhe kto janë pengesa me të cilat na po ballafaqohemi si Institucion. Ju si komision funksional na keni mbështetur por me tutje ka ngecur tek Ministria. Për sa i përket pyetjes së deputetes Sevdije Lama ne i kemi marr të gjithë hapat që duhet mi ndërrmar ndaj një operatori ilegal, janë bërë të gjitha konfiskimet kemi bërë katër vërejtje për ndërprerje të punës, i kemi dërguar gjrobat nga 10,000 euro por nuk i ka paguar prandaj tani ju shtohen 6,000,000 euro obligime të pakryera por ai duhet të ballafaqohet me gjykatën sepse lënda ka shkuar edhe për të edhe për të tjerët.

Haradin Gërvalla për sa i përket Projekteve Kapitale për vitin 2012 janë 380,000 euro dhe projekti i avancimit të Geodatabazës ka pasur një vlerë shumë të madhe prej 120,000 euro dhe kjo ka ardhur deri tek ajo përqindje që nuk është realizuar buxheti. Projekti nuk ka mundur të realizohet me arsyetimin se ne e kemi një databazë të krijuar prej Bikut. Biku ka qenë kompani Gjermane dhe është problem me ndërhy në databazë përveç kësaj kompanie dhe nëse kjo kompani nuk e dorëzon kodin burimor. Ne kemi pas disa negociata në vitin e kaluar dhe kjo është arsyeja pse këto mjete kanë mbet pa u shpenzuar.

Sali Asllanaj çka do të ndodhë nëse nuk dorëzohet kodi burimor ?

Ibush Jonuzi ne kemi bërë dy takime me kompaninë që më herët e ka kryer realizimin e këtij projekti, ata janë zotuar që do të dorëzojnë kodin burimor .Nëse nuk dorëzohet kodi burimor ne do të bëjmë padi në gjykatë , ngase nuk mundet projekti të bllokohet për shkak të mos dorëzimit të kodit burimor.

Latif Gashi nuk morra një përgjigje për sa i përket pozitive ku shohim se buxheti është shpenzuar ndërsa janë 7 pozita te pa rekrutuara.

Ibush Jonuzi pagat në KPMM është e njëjta edhe tani me atë në 2007. Neve na janë ndare 615.000 euro dhe ky është buxhet për 72 punëtor , është aprovuar shifra prej 79 punëtoreve por mjetet nuk janë ndarë.

Kryetarja qështja e të punësuarve është diskutuar edhe në takimet tjera, sepse është përcjell nga viti në vit një gjë e tillë. Institucionet e pavarura kanë të punësuar jashtë sistemit të pagave të shërbyesve civil, për shembull në KPMM merret edhe një shtesë prej 30 euro të cilin e marrin të gjithë punëtorët dhe ajo shtesë është hekur tash për shërbyesit civil, mirëpo te KPMM nuk është hekur edhe pse në ligjin për buxhet ne e kemi theksuar se duhet të hiqet për shkak të rritjes së pagave të stafit civil .

Pas diskutimeve komisioni me nëntë vota Për (Safete Hadergjona, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Sevdije Lama ,Albana Fetoshi dhe Xhevdet Neziraj), një votë Kundër (Latif Gashi) dhe asnjë abstenim nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetarja raporti vjetor i përfshinë të gjitha të dhënat të cilat janë të parapara me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjithësitë. Raporti është dorëzuar me kohë në Kuvend , dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik. Nga të dhënat shohim se plani

buxhetor për vitin është realizuar 96,3%, po ashtu i kemi të dhënat e detalizuara për të hyrat dhe në disa kategori ka rritje të hyrave, kurse në disa kategori ka pas lëvizje krahasuar me vitin 2012. Nga pagesat shohim se plani buxhetor për vitin 2012 është realizuar 92% , tek Pagat dhe Mëditjet ka pas një realizim prej 98%, Mallra dhe Shërbime 88% ,Shpenzimet Komunale 92%, Shpenzimet Kapitale 88% .

Ramadan Avdiu raporti financiar i Buxhetit të Kosovës prezanton performancën e institucioneve të Kosovës në fushën e menaxhimit të parashë publike. Pranimet për vitin 2012 janë 1,596,710 euro ndërsa plani vjetor i pagesave 1,585,740 euro të cilat janë të hyra të bartura nga viti 2011. Veçorit kualitative të këtij raporti janë ngritja substanciale në të hyra, tejkalimi i planit për të hyrat në disa kategori , ngritje kualitative në kategorinë Investimet Kapitale. Të hyrat e grumbulluara gjatë vitit 2012 duke mos përfshirë grantet e donatorëve dhe fondet në mirëbesim janë 1,537,955 euro, dhe paraqesin 96.3% të planit të përgjithshëm vjetor, kjo tregon se realizimi ka qenë në nivel të planit vjetor , ndërsa kemi një rritje prej 18% krahasuar me vitin e kaluar. Të hyrat e mbledhura në kufi arrijnë 55% të të hyrave të përgjithshme apo 88,486,100 euro apo 96% e të hyrave të planifikuara, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 2.1% për këtë kategori. Të hyrat e mbrendshme të mbledhura nga administrata tatimore arrijnë në 18.4% të të hyrave të përgjithshme, krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 8.7%. Të hyrat komunale në totalin e përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë me 3.8% , krahasuar me vitin paraprak kemi një rritje prej 6.9%. Të hyrat vetanake në nivelin qëndror ,në totalin e përgjithshëm të të hyrave marrin pjesë 2.9 % dhe janë në shumën 44,835 euro dhe kemi një ulje prej 25.2%. Të hyrat jo tatimore qeveritare paraqesin 2.6% e të hyrave të përgjithshme. Të hyrat e mbledhura nga dividenda janë në shumën prej 45.000.000 euro e këto të gjitha janë nga PTK-ja. Pranimet nga emitimi i letrave me vlerë 73,313,000 euro. Huazimet nga Institucinet Financiare ndërkombëtare janë në vlerën 93,677,000 euro, ndërsa grantet nga Banka Botërore janë shumën 37,417,000 euro. Kthimet nga të hyrat kanë qenë 2,704.000 euro nga doganat, ndërsa 32,763,000 euro nga administrata tatimore. Gjatë vitit 2012 duke mos përfshirë grantet e caktuara si dhe fondet në mirëbesim arrijnë shumën 1,466,457 euro dhe paraqesin 92% e planit të përgjithshëm vjetor .Shpenzimet nga kategoria paga dhe mëditje krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje prej 5.9%, shpenzimet nga kategoria mallra dhe shërbime dhe krahasuar me vitin 2011 kemi një rritje prej 8.2% , shpenzimet tek kategoria shërbime komunale , kanë një rritje prej 5.8%, shpenzimet tek kategoria subvencione dhe transfere kanë pasur rritje prej 9.4% dhe shpenzimet kapitale kanë një rritje prej 4.2%. Fondi i përgjithshëm i ganteve të përcaktuara nga donatorë, duke përfshirë edhe bartjet nga viti 2012 është në shumë 23,233.000 euro , gjendja e fondeve të pa shpenzuara nga grantet e përcaktuara nga donatorët 8,301,000 euro të cilat fonde do të barten në vitin vijues. Gjendja e fondeve në Buxhetin e Republikës së Kosovës me 31.12.2012 është 216,147,000 euro.

Latif Gashi është një raport gjithë përfshirës, përmbanë të gjitha kërkesat ligjore që parashihen me ligjin për menaxhimin e financave publike. Tek inkasimi i të hyrave komunale shihet se ka një rënie, a mund të na shpjegoni qka ka bërë ministrija juaj për të stimuluar inkasimin e të hyrave ku dihet se në planifikimin e të gjithave të hyrave vetanake nëpër të gjitha kuvendet komunale ka një rritje , a është në kompetencën e juaj të bashkpunoni më ngushtë dhe ti stimuloni inkasimin e tyre. Në raportin e Qeverisë është një mungesë ngase nuk është i përfshirë rekomandimet e auditorit të përgjithshëm , do të ishte mirë këto rekomandime të përfshiheshin në raport.

Hykmete Bajrami vërejtja ime në këtë raport është mos paraqitja e Shpenzimeve Kapitale. Në raportin financiar 38% e buxhetit të përgjithshëm të Kosovës janë shpenzimet kapitale dhe në këtë raport nuk kemi një detalizim se sa janë impementuar shumat e zotuar në buxhetin rishikuar dhe në komplet buxhetin e vitit 2012 , ne kemi parë se sa janë shpenzuar Investimet Kapitale mirëpo kjo nuk mjafton, do të ishte mirë që për secilin projekt të tregohet shuma se sa është implementuar .

Po ashtu zv.Ministri tha se të hyrat janë rritur prej 18%, mirëpo kjo nuk është e vërtetë sepse nuk janë rritur të hyrat janë rritur pranimet dhe kjo është një diferenc ,sepse të hyrat nga dogana nëse i krahasojmë me vitin 2011 janë rritur 3.4% , të hyrat vetanake të komunave janë rritur 6.8% ,ndërsa ka pasur një rënie të

hyrave të organizatave tjera buxhetore prej 25%,ndihmat nga grantet janë rritë për 72% krahasuar me një vit më parë , po ashtu huammarja e brendshme dhe e jashtme është rritë për 32 herë krahasuar me një vit më parë, dhe pranimet tjera ku përfshihen edhe dividendat kanë pasur rënje për 23% .Kjo do të thotë se pranimet janë rritë për 18% , por në kto pranime kanë ndikuar në masë të madhe , huamarrja e brendshme dhe e jashtme, dhe nuk është njejtë sikur me marrë borxh sikur me i rritë të hyrat sepse borxhin duhet ta kthejmë një ditë. Po ashtu fakt tjetër shqetësues është se pjesa më e madhe e të hyrave po mbledhen nga doganat ,në emër të TVSH-së janë mbledhur 400,019,000 euro ,kjo është shqetësuese sepse po i hek gjysmë miliard nga qakullimi i bizneseve dhe ATK-ja duhet të forcohet, kapacitetet të rriten dhe TVSH-ja të mblidhet brenda.Po ashtu të hyrat nga TVSH-ja kanë pasur rënje për 58,000 euro dhe kjo tregon se kemi pas një regres të aktivitetit ekonomik nëse nuk kemi pas rritje të evazionit fiskal . Tek shpenzimet , kemi parë që në shumicen e kategorive ekonomike kemi pasur një rritje , ku përfitojnë grupet e vogla të ndryshme të interesit. Po ashtu faturat e papaguara kapin një shumë mjaftë të madhe si në nivelin qendror dhe atë lokal, kështu vimë në përfundim se buxheti është komplet një mashtrim që ju bëhet qytetarve. Ne kur kemi parashikuar se qeveria mund të vijë deri te kollapsi financiar , kemi aloduar në shpenzimin 100% të kategorive.

Albana Fetoshi dihet se shumica e të hyrave mbledhen nga doganat mendoj se kjo nuk është logjik e mir se si bëhet zhvillimi ekonomik, sepse është vetëm qarllumim i parave d.m.th nuk ka prodhim nuk ka punsim pra nuk ka zhvillim ekonomik.Të hyrat nga tatimi në korporata janë 62,681.000 euro , ndërsa të hyrat nga tatimi në të ardhura personale janë 60,681.000 euro kjo do të thotë se nëse kemi kaq pak të hyra nga tatimi në korporata pak prodhojmë dhe nese kemi kaq pak të hyra nga tatimi në ardhura personale d.m.th pak punësojm .

Sali Asllanaj shqetësimi imë është për të ardhmen , ku ligji për të burgosurit politik është aprovuar ,ligji mbi veteranët e luftës do të aprovohet ,ligji mbi gratë e dhunuara është aprovuar nuk di ku do të gjejmë mjete që ti sistemojmë këto kategori. Deri më tani e kemi shtyer disi, tani PTK-ja është privatizuar , dhe ndoshta të ardhurat e menjehershme mund të jenë shumë të dobishme për një moment, mirëpo për të ardhmen e afërt nuk do ti kisha marr lakmi çfardo parti politike që vjen në qeveri dhe do të ketë telashe të medha.

Latif Gashi është e natyrshme që opozita ta kritikoj raportin, sepse qellimi i tyre është të vinë pushtet. Fjali e fundit e deputetes Bajrami , ku thotë se ne kemi parashikuar që qeveria do të falimentoj dhe nuk ka dal aj falimentim e nënkupton krejt atë që opozita tha janë nën thonjëza. Të gjitha ato suksese të hyrat , rritjet që i pëmenda e tregojnë të kundërtën.

Sali Asllanaj duhet të kemi kujdes mos të shkojmë në deficit buxhetor , sepse kemi raste të ekonomive përreth shtetit tonë, të cilat objektivisht kanë shkuar në falimentim. Prandaj duhet të kemi kujdes mos të shkojmë në atë vijë, është fat i mir që ne skemi shkuar po ai ka shku në dëmë të asaj që është planifikuar dhe duke u realizuar, janë bërë shkurtime buxhetore që të mos shkohet në atë nivel, ku me ligj i kemi jep të drejt Ministris së Financave që të bëjë shkurtime buxhetore që vendi mos të shkoj në kriz.Mirëpo pasqyrat janë të deformuara bëhet një planifikim shumë më i madhe , e realizimi bëhet shumë më i vogë në praktik .

Kryetarja Komisioni për Buxhet dhe Financa ka qenë shumë konstruktiv sepse të gjitha çështjet me të cilat është përball qeveria edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar kanë kaluar edhe përmes këtij komisioni.Ne në komision duhet të vlersojmë punën e pozitës dhe të opozitës ,për angazhimin maksimal që kanë pas në miratimin e ligjeve dhe në miratimin e çështjeve që kanë të bëjnë me stabilit makro fiskal, të cilin edhe kemi pasur obligim ta tejkalomë. Ministria e Financave bënë përmbledhjen e të gjitha shpenzimeve, të të gjitha institucioneve të qeveris dhe ndoshta janë rrethanat ktu por antarët e

komisionit gjatë shqyrtimit të buxhetit mund të thrrasin ndonjë ministër , ku kanë vlersuar vrejte në mënyren e shfrytëzimit të buxhetit, po ashtu këtë mund ta bëjnë në seancën plenare.

Latif Gashi me qenë se dha shumë vërejtje deputetja Bajrami , do të doja t'ja kirujtoja menaxhimin e buxhetit në komunën e Prishtinës , ku e keni realizuar buxhetin vetëm 73% , keni realizuar buxhetin 100% për paga dhe mëdijtje, keni shpenzuar 97% për mallra dhe shërbime e gjëja më e keqe është ajo se për projekte kapitale ka shpenzuar vetëm 55% të buxhetit si mund ta shpjegoni këtë .

Hykmete Bajrami komentet që i bëra un e kamë analizuar buxhetin dhe ato të dhëna që nuk i kam gjetur i kërkoja. Arsyja e parë se pse Prishtinës i teprojnë para, ne nuk i kemi gjepat e thell ato që teprojnë nuk i dërgojmë në shtëpi.Parat e pagave nuk ka mundësi askush në Kosovë mi vjedhë sepse askush nuk lejon me ja vjedh dikush pagën, mirëpo në shpenzime kapitale në tendera po e dimë punën si shkon.

Ramadan Avdiu për secilin projekt mund të gjinden të dhënat në thesar , për arsyjen se mund të del një raport teper voluminoz dhe kështu kemi konsideru se është me i thjesht për tu kuptuar nga të gjithë. Sa i përket mënyrës së shpenzimeve që i kanë bërë organizatat buxhetore, nese ka pas keqpërdorime eventuale nuk është çështje e Ministris së Financave , ne në përgjithësi jemi përpjekur që ta mbykqyrim shpenzimin e paras publike mirëpo ka edhe mekanizma të tjere ligjor që e mbikqyrin dhe shohin nese ka pas shpërdorime. Është e vërtet që ka pas shkurtime gjatë vitit fiskal,për shkak edhe të raporteve që ne i kemi pas me FMN dhe për shkak të performancës, po në përgjithësi trendet kanë qenë shumë pozitive si në akumulimin ashtu edhe në shfrytëzimin gjegjësisht në shpenzimin e buxhetit dhe është mir që viti ka përfund me një bilanc pozitiv bankar.Sa i përket vonesave ne nuk kemi mundur tjemë 100% të sakt sepse ka projekte që vazhdojnë me vite dhe nuk do të përfundojnë as në vitin 2014 për ata edhe mund të ketë nën shpenzime . Për sa i përket të hyrave vetanake nëpër komuna mund të them që ka një ngritje , krahasuar me vitin 2011 ,mirpo nuk është realizimi i plotë i planifikimit të komunave , prandaj ne po insistojmë që komunat të jenë me insistuese në grumbullimin e të hyrave vetanake.Për vitin e ardhshëm është parashikuar të jetë një ngritje e letë e të hyrave vetanake nëpër komuna , mirpo ajo që po vërehet është se komunat të hyrat vetanake i mbajnë nuk i shpenzojnë dhe ato i bartin nëpër vite, kurse sa i përket granteve ka kërkesa permanente që të rriten grantet specifike , granti i përgjithshëm mbetet 10% e të hyrave , por edhe grantet specifike për arsim dhe shëndetsi në mënyrë që ato shenzohen 100% kurse të hyrat vetanake zakonisht ruhen nuk shpenzohen dhe barten në vitin elektoral .Këtë vitë kemi pas bartje 33.000.000 euro nga të hyrat vetanake të vitit të kaluar dhe viteve të mëparshme për buxhetine vitit 2013.

Kryetarja raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012 është hartuar në pajtim me ligjin për menaxhimin e financave publike dhe është në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik .Është raport përmbajtësor dhe i përfshin të gjitha çështjet që i parasheh ligji për menaxhimin e financave publike dhe të gjitha çështjet të cilat janë të parapara me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit .

Pas diskutimeve komisioni me gjashtë vota Për(Safete Hadergjonaj, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Duda Balje, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj), tri votë Kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi), asnjë abstenim nxorri këtë:

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2012

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116

Kryetarja është proceduar plotësim-ndryshimi i LMFP, kryesisht ky ligj ka këto plotësime dhe ndryshime që kanë të bëjnë me caktimin e rregullave fiskale. Këtë qështje e kemi pasur objek diskutimi edhe në takimi të ndryshme të cilat i kemi pasur. Projektligji nuk ka ndonjë vërejtje serioze me përjashtim të mundësis së vendosjes së këtyre rregullave fiskale të cilat janë paraparë. I plotëson kushtet formale juridike dhe janë bashkangjitur edhe deklaratat të cilat janë të domosdoshme për të proceduar në kuvend.

Ramadan Avdiu ky plotësim ndryshim është bërë me qëllim të adresimit të disa çështjeve të rëndësishme të menaxhimit të financave publike. Një nga çështjet kryesore që trajton ky projektligj është vendosja e një rregulle fiskale për sa i përket deficitit të përgjithshëm, i cili nuk duhet të tejkaloj nivelin prej 2% të BPV. Dispozitat e këtij projektligji përmbajnë disa ndryshime sa i përket klasës së investimeve të fondit nga fondi i konsoliduar i Republikës së Kosovës, me qëllim që fondet të mund të investohen në institucione relevante financiare brenda dhe jashtë Kosovës. Po ashtu janë qartësuar një numër i konsiderueshëm i dispozitave për menaxhimin e financave publike dhe ky projektligj nuk prodhon kosto shtesë.

Pas diskutimeve, Komisionit njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 03/L-221 dhe nr. 04/L-116.

6. Shqyrtimi i Raportit financiar vjetor i Zyrës për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012

Kryetarja ajo që më ka bërë përshtypje në raportin e Zyrës për Ujësjellës dhe Kanalizim është se i ka realizuar të hyrat që i ka planifikuar 100% dhe kjo është pak problem të realizohen të gjitha të hyrat që janë planifikuar.

Raif Preteni prezentoj raportin vjetor të Zyrës për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012, ku janë të përfshira edhe nënkategorit ekonomike të cilat janë të detalizuara në raport.

Latif Gashi kisha dashtë një shpjegim të shkurtër tek nën kategoria Shërbimet Kontraktuese, i keni Planifikuar 11,000 euro e i keni shpenzuar më pak se 44%. Pse nuk i keni shpenzuar të gjitha, dhe tek nënkategoria Avanc për Udhëtime Zyrtare janë shpenzuar me pak se sa që janë planifikuar nëse keni mundësi të na tregoni pse ka ndodh kjo.

Raif Preteni arsyen se pse shpenzimet kanë qenë më pak, sepse në vitin e kaluar ne kemi pasur një projekt nga dhe një pjesë janë bartur shpenzimet, kështu që nuk kemi pasur nevojë t'i shpenzojmë kjo është arsyeja e vetme pse nuk i kemi realizuar.

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratoj Raportin vjetor financiar të Zyrës për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012.

7. Shqyrtimi i Raporti financiar vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012

Kryetarja raporti financiar i ARRH-së është realizuar në një përqindje të mirë prej 93.60% .Tek kategoria Paga dhe Mëditje ka një suficit 15.243 euro dhe kjo është interesante sepse gjithmonë kërkohej të rritet numri i punëtorëve. Po ashtu tek kategoria shpenzimet për shërbime dhe shpenzimet kontraktuale nuk kanë palinfikuar ndërsa ka pasur shpenzime.

Ili Ahmeti prezantoi raportin financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012 , ku janë të përfshira të gjitha nënkategorit ekonomike të cilat janë të detalizuara në raport. Tek kategoria mallra dhe shërbime bëhet planifikimi në total dhe në bazë të nevojës bëhet shpërndarja nëpër nënkategori.

Përfundim

Në takim të ardhshëm i detalizoni për çka kanë qenë këto shërbime kontraktuese.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për transportin rrugor me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetarja amendamentet dhe ligjet nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për transportin rrugor me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-191 për Blegtorinë me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja amendamentet nuk prodhojnë kosto shtesë buxhetore.

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr. 04/L-191 për Blegtorinë me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

10. Të ndryshme

10.1. Kryetarja njoftoi për vizitën e realizuar në Washignton së bashku me zëvendëskryetarin e parë : Nase Osmani dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ, një vizitë të rëndësishme në Washington me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe Bankën Botërore , ku pjesëmarrës ishin edhe pjesëdhjetë vendje të tjera. Në këtë takim kemi pasur takime Drejtorin e Bankës Botërore dhe Drejtoreshen FMN-së he zyrtarët të lartë të këtyre institucioneve dhe janë zhvilluar diskutime të frytshme dhe më interes për pjesëmarrësit.

10.2 Kryetarja kërkoi nga grupi punues për mbikëqyerjen e zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik të organizojë një takim javën e ardhshme për të filluar me punë konkrete.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

